

## **AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“Hellopanda” SH.P.K**

Sot me date 20.09.2022 :

- Xu Xie, atesia Jingling, shtetas Kinez lindur me 28.08.1986 ,ne Shandong Kine , banuese ne Tirane, me dokument identifikimi me nr E82047125;
- Dan Liu, atesia Yabin, shtetase Kineze lindur me 27.07.1984 ,ne Heilongjiang Kine , banuese ne Tirane, me dokument identifikimi me nr E30736750;

bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 ”Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil ne cilesine e ortakeve themelues si dhe ne vullnetin tone te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e akteve te themelimit te shoqerise kemi hartuar aktin e themelimit dhe statutin e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte shoqeria):

KREU I  
THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA  
NENI. 1  
DATA E THEMELIMIT, EMRI I THEMELUESIT

Sot ne date 20.09.2022,u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin

**“Hellopanda” SH.P.K**

1. Themeluesit e shoqerise jane :

- Xu Xie, atesia Jingling, shtetas Kinez lindur me 28.08.1986 ,ne Shandong Kine , banuese ne Tirane, me dokument identifikimi me nr E82047125;
- Dan Liu, atesia Yabin, shtetase Kineze lindur me 27.07.1984 ,ne Heilongjiang Kine , banuese ne Tirane, me dokument identifikimi me nr E30736750;



NENI. 2  
OBJEKTI I SHOQUERISE

*Objekt i kesaj shoquerie do te jete:*

Sherbirne turizmi, hoteleri, katering, restorant, bar-kafe, spa. Veprimtari në fushën e medias. Ne funksion te qellimeve te saj, shoqueria mund te hyje ne tregje dhe operacione te ndryshme, te zoteroje pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme dhe / ose te marre pjese ne shoqeri te tjera tregtare.Ushtrimi i aktivitetit brenda dhe jashte Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin.Cdo aktivitet tjeter te lidhur me aktivitetin kryesor.

Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqueria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI. 3  
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoquerise do te jete deri ne nje afat te papercaktuar  
Shoqueria mund te prishet perpara ketij afati me vendim te asamblese se Ortakeve.

NENI. 4  
SELIA E SHOQUERISE

Selia e Shoquerise eshte ne adresen: Bulevardi Deshmoret e Kombit, Qendra e Biznesit "Kullat Binjake" Kati i II, nr. 26

KREU II  
KAPITALI  
NENI. 5

KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoquerise do te jete 100.000(njeqind mijë) leke i perbere nga dy kuote.

*Pjesemarrja e ortakut themelues ne kapitalin e shoquerise eshte:*

Kontributi ne kapitalin e shoquerise eshte 100.000 leke dhe perbehet nga 2 (dy) kuota me vlore nominale 100.000 leke nga Ortaket :

- Xu Xie, atesia Jingling, shtetas Kinez lindur me 28.08.1986 ,ne Shandong Kine , banuese ne Tirane, me dokument identifikimi me nr E82047125; zoteron 80% te kuotes me vlore 80.000 leke.
- Dan Liu, atesia Yabin, shtetase Kinez lindur me 27.07.1984 ,ne Heilongjiang Kine , banuese ne Tirane, me dokument identifikimi me nr E30736750; zoteron 20% te kuotes me vlore 20.000 leke.

*R. Sm*

*Dan Liu*

Kontributet e ortakeve mund te jene ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta).

**NENI. 6**  
**ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

**NENI. 7**  
**TRANSFERIMI I KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**  
**NENI. 8**  
**ORGANET VENDIMMARRESE**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b. Ndryshimet e statutit

*R. Sm*

*Dam. W.*

- c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e. Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimitarise
- g. Miratimi,i bilanceve
- h. Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i. Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- j. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k. Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l. Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqsues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### NENI 9

#### THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PER GJITHSHME

Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbate vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullslse.

#### NENI 10

#### KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifkuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi i permendur ne paragrafin e mesiperme nuk arrihet, asambleja e per gjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

#### NENI 11

#### MARRJA E VENDIMEVE

Rosm

Dan

Asambleja e per gjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizmin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e per gjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshjen te tjera.

*Cdo ndryshim duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne registrin e shoqerise.*

#### NENI 12

#### PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendimin pet:

- a) vleresmin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konfikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

#### NENI 13

#### ADMINISTRIMI

Asambleja e per gjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte riperteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

*Personi i me poshtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te pakufizuara administrimi:*

Xu Xie, atesia Jingling, shtetas Kinez lindur me 28.08.1986 ,ne Shandong Kine , banuese ne Tirane, me dokument identifikimi me nr E82047125;

#### NENI 14

#### KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

*Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:*

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e per gjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) PergatitIn dhe nenshkruajne bilancIn vjetor, bilancIn e konsoliduar dhe raportIn e ecurlse se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratIm

Rosm

Donika

- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne edo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejtë.

#### NENI 15 PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte per gjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate admInIstrImIt te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprime ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane per gjegjes per demet e sjella shoqerise dhe per gjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.
2. Nese administratori vpron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

#### KREU IV VITI FINANCIAR -EKSPERTET NENI 16 VITI FINANCIAR

Viti finaciar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtimisht , viti i pare finaciar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllte me 31 dhjetor.

#### NENI 17 EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finaciar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara.

#### KREU 5 PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQERISE

*R. Sm*

*Dantur*

**NENI 18**  
**PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE**

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b. Me vendimet e asamblese se Ortakeve
- c. Me hapjen e procedurave te falimentit
- d. Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit,
- e. Me vendim gjykate.

**NENI 19**  
**RIORGANIZIMI I SHOQERISE**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shoqerite tregtare.

**ART. 20**  
**KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT**

Ortaket dhe administratoret e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jene te punesuar ne nje shoperi qe ushtron aktivitet ne te njejtun fushe me te paren. Ndalimi i pikes 1 mund te anulohet ne asamblene e pare te pergjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave ne sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjit per shoqerite tregtare.

**NENI 21**  
**LEGJISLACIONI**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

**NENI 22**  
**MOSMARRVEVESHJET**

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua ne 2 kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte ligjore.

**ORTAKET THEMELUES**

*Dan Lai*

*Xu Xie*

*Dan Lai*

*Dan Lai*